



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
K R Y E T A R I

Adresa: Rruga Rruga "Abdi Toptani" Nr. 1 Tiranë. E-mail: klsh.org.al; Web-site www.klsh.org.al

Nr. 55/7 Prot.

Tiranë, më 10.05.2018

**V E N D I M**

**Nr. 40, Datë 10.05.2018**

**P Ë R**

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË KËSHILLIN E QARKUT BERAT “MBI  
AUDITIMIN E RREGULLSHMËRISË”  
PËR PERIUdhËN nga 01.01.2015 DERI MË DATËN 31.12.2017.**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

**VENDOSA**

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditime rregullshmërisë, të ushtruar në Këshillin e Qarkut Berat, sipas programit të auditimit nr. 55/1 prot, datë 18.01.2018 për veprimtarinë nga data 01.01.2015. deri më datën 31.12.2017.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

**A-MASA ORGANIZATIVE**

**1-Gjetje nga auditimi:** Nga D.A.M.T., pranë Qarkut Berat bazuar në dokumentacionin e K.V.V.T.P. pranë Prefekturës së Qarkut Berat lidhur me vendimet për heqjen e titullit të

pronësisë të përfutuar në mënyrë të padrejtë, të konfirmuara me vendime gjyqësore të formës së prerë, për **14 raste** me një sipërfaqe prej **76835 m<sup>2</sup>**, është realizuar vetëm marrja dokumentare në dorëzim e sipërfaqeve që do të kalojnë në emër të shtetit. Konstatohet se aktiviteti i kësaj Drejtorie është kufizuar vetëm në evidentimin e kësaj sipërfaqe në pronësi shtet ndërkohë që nuk është vijuar me procedurat për klasifikimin sipas zërave kadastrale dhe më pas për hartimin e planeve zhvillimore të nevojshme për futjen e këtyre sipërfaqeve nën administrim shtetëror. Konstatohet një kuptim i ngushtë i funksioneve të përcaktuara në nenin 12 të ligjit nr. 8752, datë 26.03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe Mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar

Nga D.A.M.T., është bërë marrja në dorëzim e sipërfaqeve me diferenca nga Vendimi i KVVTP pranë Prefekturës së Qarkut Berat dhe AMTP-të. Kështu bazuar në dokumentacionin e KVVTP pranë Prefekturës së Qarkut Berat sipas vendimit nr. 236, datë 24.10.2013, mbi shfuqizimin e plotë të AMTP-së nr. 173, datë 25.06.1996 dhe kthimin e sipërfaqes prej 10490 m<sup>2</sup> në pronësi shtet, vendim i lënë në fuqi nga Gjykatat, bazuar në procesverbalin e datës 28.01.2015 marrja në dorëzim e sipërfaqes është bërë për 9250 m<sup>2</sup> ose më pak se vendimi i K.V dhe vendimi i Gjykatës për **sipërfaqen prej 1240 m<sup>2</sup>**. Ndërsa referuar dokumentacionit të KVVTP pranë Prefekturës së Qarkut Berat për vendimin nr. 176, datë 31.03.2011, i cili ka vendosur shfuqizimin e AMTP-ve nr. 49-207 dhe nr. 207, datë 01.06.1992 dhe kthimin e sipërfaqeve prej 19887 m<sup>2</sup> në pronësi shtet, në fakt sipas procesverbalit të marrjes në dorëzim datë 28.01.2015 është marrë në dorësim sipërfaqja 8505 m<sup>2</sup>, pra me një diferencë prej 11382 m<sup>2</sup>. Nuk konstatohet asnjë analizë për shkaqet e këtyre diferencave për të qartësuar nëse ka përgjegjësi për tu evidentuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 79-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1-Rekomandimi:** D.A.M.T. pranë Qarkut Berat, të merret me hartimin e strategjisë për një administrim të kujdesshëm të fondit të tokës, bazuar në strategjinë sektoriale dhe kuadrin rregullator në fuqi, të marrë masa për njohjen mirë të funksioneve që i ka dhënë ligji dhe për ta kthyer këtë drejtori në njësi funksionale në menaxhimin e tokës në dispozicion.

#### *Menjëherë*

**2- Gjetje nga auditimi:** Buxheti i Këshillit të Qarkut Berat është përqëndruar vetëm në realizimin e shpenzimeve korente, ndërsa nuk është gjithë përfshirës sepse fondet për përmirësim e infrastrukturës së rrugëve rurale, financimin e projekteve dhe studime e projektme për investime vecanërisht për njësitë e qeverisjes vendore me burime të pakta, të ardhurash janë në nivelin (0), për pasojë nëpërmjet buxhetimit Këshilli i Qarkut nuk ka arritur objektivat për pjesëmarrje me financim të projekteve dhe studime për projektme, veprim në mospërputhje me procedurat e UMF nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” pika 121, pasi nuk janë mbajtur akt-marrëveshje për detyrimin vjetor të NJQV ndaj KQ, nuk janë bërë përpjekje për transferimin e këtyre kuotave nga NJQV në favor të KQ. Plan buxheti përfundimtar është miratuar nga KQ Berat jashtë afateve ligjore, të cilat kanë sjellë **të ardhura të munguara në buxhetin e Këshillit të Qarkut në vlerën totale 34,732 mijë lekë**, si pasojë e formalizmit në programimin e tregueseve të buxhetit dhe burimeve të financimit, në mospërputhje me neni 32 “Përgatitja dhe miratimi i buxhetit vendor”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 84-91 të Raportit të Auditimit*).

**2.1-Rekomandimi:** Këshilli i Qarkut Berat të marr masa që programimi dhe buxhetimi në planin financiar të vitit raportues të jetë gjithpërfshirës, ndërsa prioritet ti jepet realizimit të të ardhurave nga zbatimi i kuotave të anëtarësisë së Njësisë së Qeverisjes Vendore.

#### *Menjëherë*

**3- Gjetje nga auditimi:** Projekti “Rikonstruksion i rrugës Kuc-Malas, Bashkia Ura Vajgurore” është zbatuar në mungesë të lejes së ndërtimit. Këshilli i Qarkut Berat nuk ka aplikuar për leje ndërtimi për projektin e “Rikonstruksion i rrugës Kuc-Malas, Bashkia Ura Vajgurore”, dhe ka prokuruar zbatimin e këtyre punimeve në mungesë të lejes së ndërtimit.

Mungesa e lejes së ndërtimit të objektit është në kundërshtim me nenin 39 të Ligjit nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar (Trajtuar më hollësisht në faqet 68-75 të Raportit të Auditimit).

*Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligj.*

**3.1- Rekomandimi:** Këshilli i Qarkut Berat për të gjitha projektet, të cilat sipas ligjit të sipërcituar duhet të pajisen me leje ndërtimi, të aplikojë për leje pranë bashkive përkatëse apo Këshillit Kombëtar të Territorit, sipas rastit, para se të nisë procedurën e prokurimit të punimeve.

*Në vijimësi*

**4- Gjetje nga auditimi:** Këshilli i Qarkut Berat ka hartuar projektin e rikonstruksionit dhe asfaltimit të rrugës lagja “Pjeshkorja” faza II, Bashkia Berat, në tejkalim të kompetencave të tij, pasi Drejtoria e Planifikimit të Territorit në Këshillin e Qarkut Berat, nëpërmjet inxhinierëve të saj, ka hartuar në nëntor të viti 2014 projektin e rikonstruksionit dhe asfaltimit të kësaj rruge, në situatë kur legjislacioni në fuqi nuk i lejon si kompetencë punonjësve të Këshillit të Qarkut Berat që të hartojnë projekte. Inxhinierët projektues nuk kanë paraqitur licencat profesionale. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i cili ka hyrë në fuqi në datën 01.10.2014, dhe në zbatim të nenit 11 i lë përgjegjësi Këshillit të Qarkut si vijon:

- 1. Këshilli i qarkut është përgjegjës për koordinimin e proceseve të planifikimit në nivel qarku.*
- 2. Këshilli i qarkut miraton, sipas rastit, nismën dhe dokumentet e planifikimit sektorial të qarkut.*

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 68-75 të Raportit të Auditimit).*

**4.1- Rekomandimi:** Këshilli i Qarkut Berat në zbatim të ligjit nr.107, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, të ndryshuar, të përgjigjet për ngritjen e strukturave për koordinimin e proceseve të planifikimit dhe miratimit të nismës së proceseve të planifikimit në nivel qarku. Të gjitha shërbimet e konsulencave të prokurohen sipas kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

*Në vijimësi*

**5- Gjetje nga auditimi:** Për projektin e “Rikonstruksionit dhe asfaltimit të rrugës lagja Pjeshkorja faza II, Bashkia Berat”, sipërmarrësi i punimeve “B.” shpk nuk ka hartuar dokumentacionin topografik të faktit për vendosjen e objektit në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” si edhe është shkelur afati i emërimit të kolaudatorit të punimeve, pasi emërimi i kolaudatorit “M. S.” shpk është bërë 5 muaj pas përfundimit të punimeve të ndërtimit, në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar.

*Emërimi i kolaudatorit apo i grupit të kolaudimit është detyrë e investitorit, i cili duhet që këtë t’ia komunikojë personit, institucionit që do të merret me kolaudimin dhe seksionit ose zyrës së urbanistikës të rretheve apo bashkive, brenda 30 ditëve nga përfundimi i punimeve të ndërtimit.*

Shkelja e afatit të emërimit të kolaudatorit ka sjellë vonesë në kryerjen e kolaudimit të objektit dhe marrjes në dorëzim të punimeve nga investitori, ndërsa mos hartimi i dokumentacionit topografik të faktit ka vështirësuar kontrollin e saktësisë dhe cilësisë së punimeve (Trajtuar më hollësisht në faqet 68-75 të Raportit të Auditimit).

**5.1- Rekomandimi:** Për të gjitha punimet e ndërtimit, për të cilat investitor është Këshilli i Qarkut Berat, ky i fundit të zbatojë afatin 30 ditor të emërimit të kolaudatorit dhe të kërkojë plotësimin e dokumentacionit teknik nga ana e zbatuesit të punimeve.

*Në vijimësi*

## **B. MASA SHPËRBLIM DËMI**

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga **Kryetari i Këshillit të Qarkut Berat**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën 2.788.374 lekë**, si më poshtë:

**1- Gjetje nga auditimi:** Nga rekomandimet e lëna për zbatim në auditimin e mëparshëm të KLSH, me shkresën nr. 988/7, datë 30.12.2012, në një rast, nuk ka gjetur zbatim arkëtimi i shumës **prej 200,000 lekë në emër të A.S. Përsa më lart rezulton se kjo vlerë nuk nuk është regjistruar në llogarinë 468 “debitor në persona”**, sipas rekomandimit nr. 15, (*Trajtuar më hollësisht në faqen 12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1-Rekomandim:** Këshilli i Qarkut Berat të marrë masat dhe ndjekjen e procedurave administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **200,000 lekë** në emër të A. S. detyrim i pa realizuar nga rekomandimet e KLSH, në të kundërt të nxirret përgjegjësia ndaj shkaktarit z. A. B. me detyrë ish-përgjegjës i financës.

*Menjëherë*

**2-Gjetje nga auditimi:** Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Blerje mjete fadromë për Ndërmarrjen e Rrugëve Rurale Skrapar*” është shkaktur **dëm ekonomik** shuma 238,200 lekë pa tvsh për buxhetin e Këshillit të Qarkut, shpenzim i paligjshëm i shkaktuar si diferencë ndërmjet ofertave konkurruese nga skualifikimi i ofertës ekonomike me vlerë me të ulët dhe vlerësimi i ofertës ekonomike me vlerë më të lartë, në mospërputhje me neni 52 “*Hapja e ofertave*” pikat (1); (6), neni 53/3 “*Shqyrtimi ofertave*”, neni 54 “*Alternativat*”, neni 55 “*Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese*” të LPP, (*Trajtuar më hollësisht në faqet 58-68 të Raportit të Auditimit*).

**2.1-Rekomandimi:** Këshilli i Qarkut Berat të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **238,200 lekë pa tvsh**, nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë solidare sa më poshtë;

1-z.A. G. **shuma 79,400 lekë**.

2-z.A. H. **shuma 79,400 lekë**.

3-z.L. S. **shuma 79,400 lekë**.

*Menjëherë*

**3-Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzimet nr. 93 e 94, datë 10.03.2015 janë kryer pagesa në shumën 192,216 lekë, për likuidimin e shpenzimeve të kryera pa dokumenta justifikuese me objekt; “*Dieta jashtë shtetit Itali*” ish/Shefi kabinetit K.Qarkut me destinacion *Bergamo, komuna e Milanos*, në mospërputhje me shkresën e Ministrisë së Punëve të Jashtme nr. 3548, datë 25.02.2015 për shprehje dakortësi me pjesmarrje në projektin “*Mbi sigurinë ushqimore*” i zhvilluar në Milano (*arci Bergamo*) vetëm për ish/Kryetarin, ndërsa ka marr pjesë edhe ish/Shefi kabinetit, në mospërputhje me VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” pika 3; 4; 6; 7; 8 dhe UMF nr. 22, datë 10.07.2013 “*Mbi zbatimin e VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, pika 3, me pasojë dëm ekonomik shuma 192,216 lekë (Trajtuar më hollësisht në faqet 17-36 të Raportit të Auditimit)*”.

**3.1-Rekomandim:** Këshilli i Qarkut Berat të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **192,216 lekë** nga punonjësit përfitues në mënyrë solidare sa më poshtë:

1-z.G. Z. shuma **192,216 lekë**.

*Menjëherë*

**4-Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzimin nr.96, datë 11.03.2015 është kryer pagesa në shumën 365,800 lekë pa tvsh me përfitues subjekti “Q. 01”shpk për likuidimin e shpenzimit shërbim emergjence me objekt; “*Mbi bllokimin nga dëbora të segmenteve Gjerbës -Dëvri, Zogas-Potom nga data 01-10.02.2015*”, pagesë e kryer me dokumenta shoqëruese të pa justifikuar dhe të pa argumentuar me pasojë likuidim për punime të pa kryera, në mospërputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4/24;10;11;12; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, pika 35; 36 dhe pikën 7 të Udhëzimit nr.3, datë 27.01.2015 me pasojë **dëm ekonomik** shuma **365,800 lekë pa tvsh** (*Trajtuar më hollësisht në faqet 58-68 të Raportit të Auditimit*).

**4.1-Rekomandim:** Këshilli i Qarkut Berat të marrë masat dhe të ndjekë në rrugë ligjore procedurat administrative për arkëtimin e shumës **365,800 lekë pa tvsh** nga subjekti “Q .01” shpk e përfituar tepër për punime të pakryera.

*Menjëherë*

**5- Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzimin nr.169, datë 24.04.2015 është kryer pagesë në shumën 134,538 lekë pa tvsh me përfitues subjekti “B.”shpk për likuidimin e shpenzimit shërbim emergjence me objekt; “*Mbi bllokimin e rrugës kthesa pronovik uji zi*”, pagesë e kryer me dokumenta shoqëruese të pa justifikuar dhe të pa argumentuar me pasojë likuidim për punime të pa kryera, në mospërputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4/24;10;11;12; UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, pika 35; 36 dhe pikën 7 të Udhëzimit nr.3, datë 27.01.2015 me pasojë **dëm ekonomik** shuma **134,538 lekë pa tvsh** (*Trajtuar më hollësisht në faqet 58-68 të Raportit të Auditimit*).

**5.1-Rekomandim:** Këshilli i Qarkut Berat të marrë masat dhe të ndjekë në rrugë ligjore procedurat administrative për arkëtimin e shumës **134,538 lekë pa tvsh** nga subjekti “B.” shpk e përfituar tepër për punime të pakryera.

*Menjëherë*

**6- Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzim nr.171, datë 27.04.2015 është kryer pagesa në shumën 20,000 lekë, për znj. E. Z. eksperte juridike dhe znj. N. Dh. eksperte ekonomike, shpenzim për likuidimin e pagesës së kryer me objekt; “*Shpërblim për ekspert në komisioni i ngritjes në detyrë në konkurimin e kryer në datë 08.04.2015*”, pagesë e kryer me dokumenta shoqëruese të pa justifikuar dhe të pa argumentuar, në mospërputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4/24;10;11;12 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, pika 35; 36, me pasojë **dëm ekonomik** shuma **20,000 lekë** (*Trajtuar më hollësisht në faqet 37-57 të Raportit të Auditimit*).

**6.1-Rekomandim:** Këshilli i Qarkut Berat të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **20,000 lekë** nga punonjësit përfitues në mënyrë solidare sa më poshtë:

1-znj. E. Z. shuma **10,000 lekë**.

2-znj. N. Dh. shuma **10,000 lekë**.

*Menjëherë*

**7- Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzimin nr.24, datë 29.04.2015 në procedurën e prokurimit “*blerje e vogël*” e zhvilluar me objekt; “*Blerje goma për mjeti fadromë*” është shkaktur **dëm ekonomik** shuma **14,760 lekë pa tvsh** për buxhetin e Këshillit të Qarkut, shpenzim i paligjshëm i shkaktuar si diferencë ndërmjet ofertave konkurruese nga skualifikimi i ofertës ekonomike me vlerë më të ulët dhe vlerësimi i ofertës ekonomike me vlerë më të

lartë, në mospërputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 32 “Llojet e procedurave të prokurimit”, gërma (ë) “Prokurimi me vlerë të vogël” dhe Udhëzimi APP nr.3, datë 27.01.2015 “Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël”, (Trajtuar më hollësisht në faqet 58-68 të Raportit të Auditimit).

**7.1- Rekomandimi:** Këshilli i Qarkut Berat të marr masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **14,760 lekë pa tvsh**, nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit Blerje e Vogël, në mënyrë solidare sa më poshtë:

1- A. H. shuma **4,900 lekë**.

2- B. V. shuma **4,900 lekë**.

3- A. G. shuma **4,900 lekë**.

#### **Menjëherë**

**8- Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzimin nr. 259, datë 09.07.2015 në procedurën e prokurimit “blerje e vogël” e zhvilluar me objekt; “Rrethim vorreza Palikesh” është shkaktur **dëmi ekonomik** në shumën **78,000 lekë pa tvsh** për buxhetin e Këshillit të Qarkut Berat, shpenzim i paligjshëm i shkaktuar si diferencë ndërmjet ofertave konkurruese nga skualifikimi i ofertës ekonomike me vlerë me të ulët dhe vlerësimi i ofertës ekonomike me vlerë më të lartë, në mospërputhje me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 32 “Llojet e procedurave të prokurimit”, gërma (ë) “Prokurimi me vlerë të vogël” dhe pika 5 e Udhëzimi APP nr.3, datë 27.01.2015 “Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël” (Trajtuar më hollësisht në faqet 58-68 të Raportit të Auditimit).

**8.1- Rekomandimi:** Këshilli i Qarkut Berat të marr masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **78,000 lekë pa tvsh**, nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit Blerje e Vogël, në mënyrë solidare sa më poshtë:

1-z. A. H. shuma **26,000 lekë**.

2- B. V. shuma **26,000 lekë**.

3- A. G. shuma **26,000 lekë**.

#### **Menjëherë**

**9-Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzimin nr.346, datë 03.09.2015 në procedurën e prokurimit “blerje e vogël” e zhvilluar me objekt; “Rikonstruksion i rrugës Kulmak” është kryer pagesa në shumën 153,000 lekë pa tvsh me përfitues subjekti “T. M.” person fizik, pagesë e kryer me dokumenta shoqëruese të pa justifikuar dhe të pa argumentuar me pasojë likuidim i punimeve të pa kryera, në mospërputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4/24;10;11;12; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e asetëve në sektorin publik”, pika 35; 36 dhe Udhëzimi nr. 3, datë 27.01.2015 me pasojë **dëm ekonomik** shuma **153,000 lekë pa tvsh** (Trajtuar më hollësisht në faqet 58-68 të Raportit të Auditimit).

**9.1-Rekomandim:** Këshilli i Qarkut Berat të marr masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **153,000 lekë pa tvsh** nga subjekti “T. M.” person fizik, përfituar tepër për punime të pakryera.

#### **Menjëherë**

**10- Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzimi nr. 238, datë 04.10.2016 është kryer pagesa në shumën 10,000 lekë për likuidimin e shpenzimit të kryer me objekt; “Dieta brenda vendit” e përfituar nga punonjësi i administratës së K.Qarkut me destinacion (Tiranë e Gjirokastrë) pa dokumenta justifikuese dhe argumentuese, në mospërputhje me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” i ndryshuar, me pasojë **dëm ekonomik** shuma **10,000 lekë** (Trajtuar më hollësisht në faqet 37-57 të Raportit të Auditimit).

**10.1- Rekomandim:** Këshilli i Qarkut Berat të marr masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **10,000 lekë** nga punonjësi përfitues i shpenzimit z. E. B.

## **Menjëherë**

**11-Gjetje nga auditimi:** Nga inventarizimi fizik i pasurisë gjendje në datën 31.12.2016 dhe datë 30.11.2017, në fletë inventarizimit fizik i kryer me objekt; *“materiale e inventari i imët”* që i përket llogarisë (218) është evidentuar dhe pasqyruar në numërin rendor (11) artikulli *“Laptop Acer Asfrie”* me gjendje kontabile 1(një) copë me cmim 92,000 lekë dhe gjendje në fakt (0) lekë pa shifër, ndërsa nuk është nxjerrë rezultati i inventarizimit në mungesë fizike për sasia 1(një) copë artikulli *“Laptop Acer Asfrie”* me pasojë **dëm ekonomik shuma 92,000 lekë** në ngarkim të punonjësit përgjegjës material znj. J. M., në mospërputhje me ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 *“Për kontabilitetin e pasqyrat financiare”*, pika 1, neni 7 *“Inventari i aktiveve e detyrimeve”*; ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* i ndryshuar me ligjin nr.110/2015, datë 15.10.2015, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*, Kreu IV *“Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, inventarizimi i aktiveve”* (Trajtuar më hollësisht në faqet 37-57 të Raportit të Auditimit).

**11.1-Rekomandim:** Këshilli i Qarkut Berat të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për sistemimin e diferencës së rezultuar në inventarizim, nëpërmjet arkëtimit të shumës **92,000 lekë**, ose kthimin e artikullit *“Laptop Acer Asfrie”* nga punonjësi përgjegjës material znj. J. M.

## **Menjëherë**

**12- Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *“Rikonstruksioni i rrugës Kuc-Malas, Bashkia Ura Vajgurore”*, me kontraktor *“S.”* shpk, rezultoi se trashësia e shtresës së cakëllit e përdorur në objektin është më e vogël se ajo e përcaktuar në projekt-preventivin e punimeve.

Nga matjet e kryera në terren përse i përket trashësisë së shtresës së cakëllit të përdorur, rezulton se trashësia mesatare e saj është 10 cm. Pra ndonëse sipërmarrësi i punimeve është paguar për shtrimin e një shtrese prej 15 cm, në realitet shtresa në mesataren e saj nuk i kalon 10 cm. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 514, datë 15.8.2007 *“Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”* të ndryshuar.

*Pika 9. Vlera e zërave të punës të situacioneve të ndërtimit del nga prodhimi i volumeve të punës, të llogaritura në librezën e masave të zbatimit me çmimet për njësi të llogaritura mbi bazën e analizave teknike të punimeve të ndërtimit, sipas vlerave faktike.”*

si edhe me Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 *“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”* Kreu II, pika 8 dhe 8.1

*8. Punimet e përfunduara dhe të marra në dorëzim në kantier paraqiten nga sipërmarrësi në situacione pjesore, sipas periudhave progresive të zhvillimit të punimeve, dhe në atë përfundimtar.*

*8.1 Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasi, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës.*

Duke ju referuar sasisë prej 7,739 m<sup>2</sup> dhe cmimit prej 500 lekë/m<sup>2</sup> të zërit të punimit 3.210 *“Shtresë cakëlli mbeturinë kave t=15cm, përhapur e ngjeshur me makineri”*, të paraqitur në situacionin përfundimtar, rezulton se vlera e punimeve të paguara, por të pa kryera është **1,289,860 lekë që përbën dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit** (Trajtuar më hollësisht në faqet 68-75 të Raportit të Auditimit).

**12.1- Rekomandimi:** Këshilli i Qarkut Berat të kërkojë arkëtimin e dëmit nga subjekti *“S.”* shpk për vlerën **1,289,860 lekë, të përfituar padrejtësisht.**

## **Menjëherë**

## **B.1 -MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TE FONDEVE PUBLIKE.**

**1-Gjetje nga auditimi:** Në tenderin e zhvilluar me objekt; “*Blerje mjeti Fadromë për Ndërmarrjen e Rrugëve Rurale Skrapar*” me vlerë **3,598,800 lekë** e cila përbën vlerën totale të kontratës së lidhur e likuiduar pas marrjes në dorëzim të mjetit fadrom pa plotësuar kërkesat e specifikimeve teknike të DST, për pasojë kontrata është likuiduar për mall jashtë kushteve teknike, në mospërputhje me kërkesat e parashikuara nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, çka përbën efekt financiar negativ për llogari të buxhetit të Këshillit të Qarkut Berat (*Trajtuar më hollësisht në faqet 58-68 të Raportit të Auditimit*).

**1.1- Rekomandimi:** Titullari i Autoritetit Kontraktor të analizojë vlerën prej **3,598,800 lekë**, si pagesë e likuiduar në mënyrë të **paligjshme me efekt financiar negativ** për buxheti Këshillit të Qarkut, në lidhje me realizimin e kontratës për blerjen e mjetit fadromë e marr në dorëzim pa plotësuar specifikimet teknike të miratuara me DST, duke nxjerr përgjegjësinë ndaj komisionit të marrjes në dorëzim i përbërë nga A. K., L. S., V. M., B. K.

*Menjëherë*

**2- Gjetje nga auditimi:** Në tenderi e zhvilluar me objekt “*Blerje mjet transporti vetshkarkues për Ndërmarrjen e Rrugëve Rurale Berat*” me vlerë **2,820,000 lekë** e cila përbën vlerën totale të kontratës së lidhur dhe likuiduar pas marrjes në dorëzim të mjetit fadrom pa plotësuar kërkesat e specifikimeve teknike të DST, për pasojë kontrata është likuiduar për mall jashtë kushteve teknike, në mospërputhje me kërkesat e parashikuara nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, çka përbën efekt financiar negativ për llogari të buxhetit të Këshillit të Qarkut Berat (*Trajtuar më hollësisht në faqet 58-68 të Raportit të Auditimit*).

**2.1- Rekomandimi:** Titullari i Autoritetit Kontraktor të analizojë vlerën prej **2,820,000 lekë**, si pagesë e likuiduar në mënyrë të **paligjshme me efekt financiar negativ** për buxhetin e Këshillit të Qarkut, në lidhje me realizimin e kontratës për blerjen e mjetit fadromë e marr në dorëzim pa plotësuar specifikimet teknike të miratuara me DST, duke nxjerr përgjegjësinë ndaj komisionit të marrjes në dorëzim i përbërë nga A. K., L. S., V. M., B. K.

*Menjëherë*

**3- Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzim nr.17, datë 12.01.2015 është likuiduar subjekti “*O. TV*”sha, për shpenzime publikimi televiziv nga Këshilli i Qarkut me vlerën **25,000 lekë pa tvsh**, pagesë e kryer me dokumenta shoqëruese të pa justifikuar e pa argumentuara, pa specifikuar çfarë publikimi është transmetuar dhe koha e transmetimit, në mospërputhje me kërkesat e parashikuara nga VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 40, çka përbën efekt financiar negativ për llogari të buxhetit të Këshillit të Qarkut (*Trajtuar më hollësisht në faqet 58-68 të Raportit të Auditimit*).

**3.1- Rekomandimi:** Titullari i njësisë shpenzuese të analizojë vlerën prej **25,000 lekë me tvsh**, si pagesë e likuiduar në mënyrë të **paligjshme me efekt financiar negativ** për buxhetin e Këshillit të Qarkut, në lidhje me trasmetimin televiziv e pa shoqëruar me dokumenta justifikuese, pa argumentuara, duke nxjerr përgjegjësinë ndaj personave përkatës.

*Menjëherë*

**4-Gjetje nga auditimi:** Me 4 urdhër shpenzime është likuiduar subjekti “*D. R. S. T. R.*” Berat dhe Regjistri barrës siguroese, për shpenzime të prapambetura të taksës vjetore të mjetit të Këshillit të Qarkut me vlerë **136,012 lekë**, pagesë e pa shoqëruar me dokumenta justifikuese, pa argumentuar dhe specifikuar se cila taksë vjetore nuk është likuiduar, në mospërputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4/24;10;11;12; UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, pika 35; 36, çka përbën efekt financiar negativ për llogari të buxhetit të Këshillit të Qarkut



*(Trajtuar më hollësisht në faqet 58-68 të Raportit të Auditimit).*

**4.1- Rekomandimi:** Titullari i njësisë shpenzuese të analizojë vlerën prej **136,012 lekë**, si pagesë e likujduar në mënyrë të **paligjshme me efekt financiar negativ** për buxhetin e Këshillit të Qarkut, në lidhje me pagesën e taksave të prapambetura përfshirë edhe gjobën e pa shoqëruar me dokumenta justifikuese, pa argumentuara, duke nxjerr përgjegjësinë ndaj personave përkatës.

#### **Menjëherë**

**5-Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzime nr.536, datë 19.12.2014 dhe nr.461, 30.10.2014 në vlerë totale 401,042 lekë, janë kryer pagesa me përfitues subjekti “S.”shpk për likuidim të situacioneve të prapambetura nga periudhat e mëparshme në punimet e kryera me objekt; “*Punime në fasadën e zyrave të qendrës shëndetësore Berat*”, si edhe urdhër shpenzim nr. 69, datë 11.03.2015 në vlerë 12,000,000 lekë është kryer pagesë me përfitues subjekti “G.” shpk për likuidim të situacioneve të prapambetura nga periudhat e mëparshme në punimet e kryera me objekt; “*Rruga Veterik Guri Bardhë*”. Këto pagesa të prapambetura të likuiduara me vlerën totale prej **12,401,042 lekë**, janë kryer me dokumenta shoqëruese të pa justifikuara dhe të pa argumentuara me specifikimin e nevojshëm për likuidim, sepse referuar në pasqyrën financiare të periudhave raportuese të mëparshme në Klasa 4 “*Detyrime afat shkurtëra*”, llog.(401-408) “*Furnitor e llogari të lidhura me to*” rezulton se, njësia shpenzuese detyrime të pa likuiduara ka vetëm vlerën 360,000 lekë. Këto veprime janë në mospërputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4/24;10;11;12 dhe UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, pika 35; 36, çka përbën efekt financiar negativ për llogari të buxhetit të Këshillit të Qarkut *(Trajtuar më hollësisht në faqet 58-68 të Raportit të Auditimit)*.

**5.1-Rekomandimi:** Titullari i njësisë shpenzuese të analizojë vlerën prej **12,401,042 lekë**, si pagesa të likujduara në mënyrë të **paligjshme me efekt financiar negativ** për buxhetin e Këshillit të Qarkut të cilësuar të prapambetura, sepse në pasqyrën financiare Klasa (4) nuk rezultojnë detyrime të pa likuiduara të periudhave të mëparshme, ndërsa likuidimet janë kryer pa bashkëlidhur dokumentat justifikuese, duke nxjerr përgjegjësitë përkatës.

#### **Menjëherë**

**6-Gjetje nga auditimi:** Me disa urdhër shpenzime për periudhën objekt i auditimit (2015; 2016; 2017) janë kryer pagesa në shumën **333,197 lekë** shpenzime me objekt likuidimi përdorimit të telefonisë celulare nga punonjësit e Këshillit të Qarkut me funksione (*Kryetar, Nën/Kryetar, Shef kabineti dhe Sekretar Këshilli sipas tabelës në projektraport*), në mospërputhje me VKM nr. 864, datë 23.07.2010 “*Për paisjen me numër telefonie celulare të personave juridik, publik*”, pikat 11 e 14; ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” neni 4/24,10,11.12; UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, pika 35, 36 dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 40, çka përbën efekt financiar negativ për llogari të buxhetit të Këshillit të Qarkut *(Trajtuar më hollësisht në faqet 37-57 të Raportit të Auditimit)*.

**6.1-Rekomandim:** Titullari i njësia shpenzuese, Këshilli i Qarkut Berat të analizojë vlerën prej **333,197 lekë**, si pagesë e likujduar në mënyrë të **paligjshme me efekt financiar negativ** për buxhetin e Këshillit të Qarkut, duke ju referuar urdhërit të titullarit nr.16, datë 15.01.2015 i cili nuk mund të ketë efekt për periudha parardhëse, në këto kushtë titullari me analizë të saktësojë faturat e likujduara për periudhën e vitit 2014, duke nxjerr përgjegjësitë përkatës nga përdoruesit e telefonisë celulare për këtë periudhë evidentuar me tabelën përkatëse.

#### **Menjëherë**

**7-Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzim nr.398, datë 29.12.2016 është kryer pagesë në shumën 351,516 lekë me përfitues subjekti “P.” shpk për likuidimin e shpenzimit shërbim emergjence me objekt; “*Punime emergjence në rrugët e fshatit Cukas*”, pagesë e kryer me dokumenta shoqëruese justifikuese të dërguara me objeksione për projektraportin me foto në objekt dhe argumentin se; “*dokumentat ish-in depozituar në bashkia Berat që ka rrugën në*

*juridiksion*”, për pasojë likuidimi është kryer me dokumenta shoqëruese të pa justifikuara për punimet e kryera, në mospërputhje me ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4/24;10; 11; 12; UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, pika 35; 36 dhe pika 7 e Udhëzimit nr.3, datë 27.01.2015, çka përbën efekt financiar negativ për llogari të buxhetit të Këshillit të Qarkut (*Trajtuar më hollësisht në faqet 58-68 të Raportit të Auditimit*).

**7.1-Rekomandim:** Titullari i njësisë shpenzuese Këshilli Qarkut të analizojë vlerën **351,516 lekë**, si pagesë e cila **përbën efekt financiar negativ** për buxheti Këshillit të Qarkut, duke analizuar dokumentat justifikuese të paraqitura me objeksionet dhe nxjerr përgjegjësi për punimet e kryera në objekt.

#### *Menjëherë*

**8-Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzim nr.124, datë 04.05.2017 është kryer pagesë në shumën 480,139 lekë me përfitues subjekti “E. K.” shpk për likuidimin e shpenzimit shërbim emergjence me objekt, “*Punime emergjence në rrugën e fshatit Paraspuar e Terpan*”, pagesë e kryer me dokumenta shoqëruese justifikuese të dërguara me objeksione për projektraportin me foto në objekt dhe argumentin se; “*dokumentat ishin depozituar në bashkia Polican që ka rrugën në juridiksion*”, për pasojë likuidimi është kryer me dokumenta shoqëruese të pa justifikuara për punimet e kryera, në mospërputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4/24;10;11;12; UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, pika 35; 36 dhe pika 7 e Udhëzimit nr.3, datë 27.01.2015, çka përbën efekt financiar negativ për llogari të buxhetit të Këshillit të Qarkut (*Trajtuar më hollësisht në faqet 58-68 të Raportit të Auditimit*).

**8.1-Rekomandim:** Titullari i njësisë shpenzuese Këshilli Qarkut të analizojë vlerën **480,139 lekë**, si pagesë e cila **përbën efekt financiar negativ** për buxhetin e Këshillit të Qarkut, duke analizuar dokumentat justifikuese të paraqitura me objeksionet dhe nxjerr përgjegjësi për punimet e kryera në objekt.

#### *Menjëherë*

**9. Gjetje nga auditimi:** Gjendja aktuale e rrugës Kuc-Malas, Bashkia UraVajgurore është e dëmtuar dhe një pjesë e mirë shtresës së cakëllit është gërryer nga shirat. Nga vëzhgimi dhe matjet në terren, rezulton se ndonëse punimet kanë vetëm 10 muaj që kanë përfunduar gjendja e rrugës është e dëmtuar dhe një pjesë e mirë shtresës së cakëllit është gërryer nga shirat.

Parashikimi i përmirësimit të gjendjes së rrugës duke u bazuar vetëm në dy zëra punimesh përkatësisht 3.95/a *Gërmim dheu me eskavator zinxhir 0.25m<sup>3</sup> në kanale gjerësi deri 2 m, toke zak, kategoria III me shk në tokë dhe 3.210 Shtresë cakëlli mbeturinë kave t=15cm, përhapur e ngjeshur me makineri, përbën përdorim pa efektivitet të fondit prej 4,747,179 lekë*. Kjo situatë është shkaktuar si rrjedhojë e parashikimit të fondit për punime të cilat nga vetë natyra e tyre paraqiten si të përkohshme dhe nuk i japin zgjidhje të qëndrueshme dhe afatgjatë përmirësimit të kushteve të rrugës. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 4.

*Punimet e ndërtimit, të përkufizuara në nenin 3, duhet të projektohen dhe të zbatohen në tërësi ose në pjesë të veçanta në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre, duke pasur parasysh edhe anën ekonomike të tyre. Ato duhet të plotësojnë kërkesat që kanë të bëjnë me rezistencën dhe qëndrueshmërinë mekanike;*

(*Trajtuar më hollësisht në faqet 68-75 të Raportit të Auditimit*).

**9.1- Rekomandimi:** Për të gjitha punimet e ndërtimit, Këshilli i Qarkut Berat të marrë masa që në parashikimin e projekteve dhe fondeve për realizimin e punimeve, të bazohet në parimet e ekonomicitetit eficient dhe efektivitetit me qëllim realizimin e punimeve **cilësore dhe të qëndrueshme në kohë**.

#### *Në vijimësi*

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga Këshilli i Qarkut Berat, për vitet 2015, 2016 dhe 2017, janë kryer pagesa me efekt financiar me një vlerë prej **13,430,230 lekë**, ndaj ish-punëmarrësve, pagesa të cilat rrjedhin nga vendime gjyqësore për largimet nga puna. Nga auditimi rezultoi se ndërprerjet e marrëdhënieve të punës nga punëmarrësit ishin kundërshtuar në gjykatë të Shkallës Parë dhe atë të Apelit, pa u realizuar të treja shkallët e gjykimit, duke kërkuar kundërshtimin e urdhërave të largimit nga puna apo mos lidhje të kontratave të punës nga ana e ish-Kryetarit të Këshillit të Qarkut dhe pagesën e dëmshpërblimeve. Përsa më lart këto pagesa janë kryer nga të ardhurat e realizuara nga vetë Këshilli i Qarkut, *(Trajtuar më hollësisht në faqet 25-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

**10.1-Rekomandim:** Këshilli i Qarkut Berat të eliminojë praktikën e largimeve me efekte financiare, ndërsa për vendimet gjyqësore në vazhdim të kërkohet ndjekja e të tri shkallëve të gjyqësorit.

*Menjëherë*

### **C. MASA DISPLINORE:**

#### **C.1-Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.**

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH<sup>së</sup> të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të nenit 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmartjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe nenin 64 germat “g” dhe “k” të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i rekomandojmë Kryetarit të Këshillit të Qarkut Berat, që ti kërkojë Komisionit Disiplinor pranë Institucionit të Këshillit të Qarkut Berat, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, për punonjësit e mëposhtëm:

**a-“Vërejtje” e parashikuar nga neni 58, shkronja (a) të ligjit nr. 152/2013,** për 8 nëpunësit civil, si më poshtë:

**1- A. P.** me detyrë Drejtor D.A.M.T. Qarku Berat.

**2- B. V.** me detyrë përgjegjëse e zyrës së financës, në cilësinë anëtare e komisionit të blerjeve me vlerë e vogël.

**3-D. T.** me detyrë përgjegjëse Kabineti në cilësinë anëtare e njësisë prokurimit.

**4-Xh. T.** me detyrë Specialist në Këshillin e Qarkut, Berat, në cilësinë anëtar i komisionit të blerjeve me vlerë e vogël.

**5-F. Dh.** me detyrë Specialist në Këshillin e Qarkut, Berat, në cilësinë anëtar i komisionit të blerjeve me vlerë e vogël.

**6-G. A.** me detyrë Specialist në Këshillin e Qarkut, Berat, në cilësinë anëtar i komisionit të blerjeve me vlerë e vogël.

**7-P. O.** me detyrë Specialist në Këshillin e Qarkut, Berat, në cilësinë anëtar i komisionit të blerjeve me vlerë e vogël.

**8-Dh.P.** me detyrë Jurist në Këshillin e Qarkut, Berat, në cilësinë anëtar i komisionit të blerjeve me vlerë e vogël.

**Për shkeljet e mëposhtme:**

-Në lidhje me mangësitë e konstatuara në mbajtjen e dokumentacionit në administrimin e tokës, me kryerjen e parregullta të procedurave të prokurimit me vlerë e vogël lidhur me vlerësimin e ofertave konkurruese të shpalluara fituese në blerjet e realizuara, njëkohësisht edhe për pagesat e shpenzimeve të kryera për punime me emergjencë, në periudhën raportuese 2015; 2016; 2017, në mospërputhje me nenin 4/26 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, nenin 53/3 dhe 68, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenin 40 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” *(Trajtuar më hollësisht në faqet 58-68 dhe 79-86 të Raportit të Auditimit)*

### **C.2-Për punonjësit e larguar nga detyra dhe që nuk kanë adresim institucional:**

**Për ish punonjësin e mëposhtëm, do të propozohet masa disiplinore “Largim nga shërbimi civil” e parashikuar në nenin 58 gërma (c),** për shkeljet të natyrës administrative të konstatuara në auditimin e kryer në Këshilli i Qarkut Berat, pavarësisht se nuk ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënie, ndjekje e zbatim.

**1-A. B.,** në funksionin e ish/Përgjegjës i Sektorit të financës.

**2-G. A.,** në funksionin ish/jurist në Njësia e Prokurimit.

**3-V. M.,** në funksionin ish/Specialit në Këshilli Qarkut.

**4-A. G.,** në funksionin ish/Drejtor i Kordinimit.

**5-A. H.,** në funksionin ish/Jurist në Këshilli Qarkut.

**6-L. S.,** në funksionin ish/Specialit në Këshilli Qarkut.

### **D-MASA ADMINISTRATIVE:**

#### **D/1-Për Agjencinë e prokurimit publik.**

Mbështetur në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike në nenet 4, 12, 19/7, 21, 23, 25, 28, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 46, 53, 56, 63, 77, etj, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar në aktkonstatimin dhe vërejtjet, komentet e subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe nenin 15 germa (c, ç) dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik** të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (*dënim me gjobë*) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin Autoritetit Kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), të 4 punonjësve për 2 procedura prokurimi, si më poshtë:

**1-z. A. G.** me detyrë ish/Drejtor i Kordinimit në Këshilli i Qarkut Berat, në cilësinë e anëtarit të Komisionit për marrje në dorëzim të mjetit në kushte jashtë specifikimeve teknike DST në kontratën e lidhur dhe të likuiduar.

**2-z.L. S.,** me detyrë ish/Specialist në Këshilli i Qarkut Berat, në cilësinë e anëtarit të Komisionit për marrje në dorëzim të mjetit në kushte jashtë specifikimeve teknike DST në kontratën e lidhur dhe të likuiduar.

**3-z.V. M.,** me detyrë ish/Specialist në Këshilli i Qarkut Berat, në cilësinë e anëtarit të Komisionit për marrje në dorëzim të mjetit në kushte jashtë specifikimeve teknike DST në kontratën e lidhur dhe të likuiduar.

**4-z. B. K.,** me detyrë drejtues i mjetit në Ndërmarrja e rrugëve Corovodë, në cilësinë e anëtarit të Komisionit për marrje në dorëzim të mjetit në kushte jashtë specifikimeve teknike DST në kontratën e lidhur dhe të likuiduar.

#### **Për shkeljet e mëposhtme:**

-Për marrjen në dorëzim të automjetit, në kushtet pa plotësuar kërkesat e Specifikimeve teknike të miratuara në DST, në kontratat e lidhura me operatorët e shpallur fitues në procedurat e prokurimit me objekt “*Blerje mjeti Fadromë për Ndërmarrjen e Rrugëve Rurale Skrapar*” dhe në procedurën “*Blerje mjet transporti vetshkarkues për Ndërmarrja e Rrugëve Rurale Berat*”, duke sjellë pasojë likuidimin e kontratë për marrje në dorëzim të mjetit në kushte jashtë specifikimeve teknike DST, në mospërputhje me kërkesat e parashikuara nga neni 23 “Specifikimet teknike”, pika 5 të ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 57-68 të Raportit të Auditimit*).

#### **D/2- Për Ministrinë Zhvillim Urban (Për Komisionin e Licencave)**

Mbështetur në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, VKM nr. 759, datë 12.11.2014 “Për Licencimin Profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit” dhe në nenin 13, nenin 25 dhe pika 1/a, 1/e, e nenit 41, Kreu VI-të, “Sanksione dhe Dispozita kalimtare”, për shkelje të ligjshmërisë në studim projektim e hartim preventivi, në fushën e ndërtimit, **i rekomandojmë** Komisionit të Dhënies së Licencave, pranë Ministrisë së Energjitikës dhe Infrastrukturës që të vlerësojë shkeljet e konstatuara duke vendosur sanksionin e heqjes së licencës së ushtrimit të profesionit për subjektin projektues “H. C.” shpk, për një afat kohor **prej 6 muajsh**, si më poshtë:

**1. Për subjektin “H. C.” shpk, me administrator z. H. H., me nr. licence N-6724/1, për shkak se:**

Preventivi i projektit “Rikonstruksion i rrugës Kuc-Malas, Bashkia Ura Vajgurore” është i pabazuar në një projekt të mirëfilltë dhe në një gjurmë reale të rrugës. Projekti nuk ka një gjurmë të saktë të rrugës, rievim topografik, profile gjatësore e tërthore dhe studim gjeologjik. I gjithë projekti përbëhet nga një foto satelitore dhe një gjurmë e dhënë me dy vija. Për sa më sipër rezulton se preventivi i hartuar është i pabazuar në një projekt të mirëfilltë dhe në një gjurmë reale të rrugës. Kjo është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 5.

*Neni 5. Punimet e ndërtimit, të përkufizuara në nenin 3, duhet të projektohen dhe të zbatohen në tërësi ose në pjesë të veçanta në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre, duke pasur parasysh edhe anën ekonomike të tyre.*

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e punimeve të ndërtimit në nenet 3 dhe 5, të ligjit 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në akt konstatimin nr. 2, datë 02.03.2018, vërejtjeve komentet të subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit.

### **D/3- Për Inspektoriatin e Mbrojtjes Territorit Vendor (IMTV), Bashkia Ura Vajgurore.**

Mbështetur në ligjin nr. 183/2014 datë 01.04.2013 “Për Inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” dhe nenin 15 ”Sanksionet”, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar dhe bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për shkelje të ligjshmërisë në mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit, i kërkojmë:

**Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore të Bashkisë Ura Vajgurore,** që ka në juridiksion territorin ku ndodhen objekti i trajtuar sipas kontratave (duke i bashkëlidhur fotokopjen e procesverbalit përkatës që trajton çështjen), që të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur sanksionet si më poshtë:

**Dënimin me gjobë, për një mbikëqyrës të punimeve të ndërtimit, respektivisht:**

**1. z. A. K.,** administrator i subjektit “S.” shpk, mbikëqyrës i punimeve, me licencë nr. NZ.4912/10, me të cilin është lidhur kontrata e sipërmarrjes me Këshillin e Qarkut Berat datë 06.03.2017, për mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit për objektin “Rikonstruksioni i rrugës Kuc-Malas, Bashkia Ura Vajgurore”, për shkak se:

Sipërmarrësi i punimeve “S.” shpk gjatë zbatimit të punimeve të ndërtimit, nuk ka hartuar dokumentacionin topografik të faktit për vendosjen e objektit “Rikonstruksioni i rrugës Kuc-Malas, Bashkia Ura Vajgurore”, në kantier nuk ka hartuar dokumentacion topografik ku të vërtetojë kontrollin e vazhduar, saktësinë dhe cilësinë e punimeve. Sa më sipër është në kundërshtim me nenin 9 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e

*punimeve të ndërtimit” të ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu III dokumentacioni teknik i punimeve të ndërtimit.*

*Gjatë zbatimit të punimeve të ndërtimit, në kantier hartohet e grumbullohet dokumentacioni teknik, që vërteton kontrollin e vazhduar, saktësinë dhe cilësinë e punimeve, i cili përmban:*

*a) Dokumentacionin topografik të faktit për vendosjen e objektit e të rrjeteve të infrastrukturës, për lidhjen e themeleve e të bazamenteve me tabanin, për kontrollin në plan e lartësi të objektit, të strukturave mbajtëse etj.*

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e punimeve të ndërtimit në nenin 9 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në akt konstatimin nr. 2, datë 02.03.2018, vërejtjeve komentet të subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit. Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, **i rekomandojë** Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor që të vlerësojë shkeljet e kontatuara duke vendosur masa për dënimin me gjobë prej **50,000 lekë** për zbatuesin e objektit “S.” shpk, për mos plotësimin e detyrimit të hartimit të dokumentacionit topografik të zbatimit të projektit nga sipërmarrësi i punimeve.

## **E- PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL**

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, (Njësia e Burimeve Njerëzore e Institucionit), pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

2. Të njoftojë Komisionarin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 ”Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

**Shënim:** Për **A. B.**, në funksionin e ish/Përgjegjës i Sektorit të financës, dalë në pension, **G. A.**, në funksionin ish/jurist Njësia e Prokurimit në Këshillin e Qarkut larguar nga puna, **V. M.**, në funksionin ish/Specialit në Këshillin e Qarkut larguar nga puna, **A. G.**, në funksionin ish/Drejtor i Kordinimit larguar nga puna, **A. H.**, në funksionin ish/Jurist në Këshilli Qarkut larguar nga puna dhe **L. S.**, në funksionin ish/Specialit në Këshilli Qarkut larguar nga puna, do të rekomandonim masë disiplinore “*Largim nga shërbimi civil” e parashikuar në nenin 58 gërma (ç)*”, **por për shkak se kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me Këshillin e Qarkut Berat, masat ndaj tyre konsiderohen të ezauruara.**

## **F. INDICE PENALE**

Bazuar në nenin 281, të Ligjit nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 12, të Ligjit nr. 8752, datë 26.03.2001 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës”, i ndryshuar, i është kërkuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat, për t’u studiuar si Indice Penale, për çdo pikë që mund ta konsiderojë prokuroria, duke i vënë në dispozicion Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Vendimin e Kryetarit për këtë auditim.

*Në rastin e fillimit të proceseve gjyqësore në funksion të zbatimit të këtyre rekomandimeve, nga ana e Këshillit të Qarkut Berat, të kërkohet prezenca e KLSH-së, si palë e tretë në proces*

*gjqësor, duke e informuar njëkohësisht KLSH-në, në lidhje me ecurinë dhe zhvillimet përgjatë procesit gjyqësor.*

*Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore.*

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**